# UDHËZUESI PËR MONITORIMIN DHE MBËSHTETJEN E EKZEKUTIMIT TË GJYKIMEVE TË GJYKATËS KUSHTETUESE

COUNCIL OF EUROPE
CONSEIL DE L'EUROPE

# UDHËZUESI PËR MONITORIMIN DHE MBËSHTETJEN E EKZEKUTIMIT TË GJYKIMEVE TË GJYKATËS KUSHTETUESE

përgatitur nga

**Mirjana Lazarova Trajkovska**
**Ledi Bianku**

**2023**

COUNCIL OF EUROPE

Ky publikim është përgatitur në kuadër të Projektit mbi Mbështetjen ndaj Gjykatës Kushtetuese në Aplikimin dhe Shpërndarjen e Standardeve Evropiane të të Drejtave të Njeriut, zbatuar nga Këshilli i Evropës dhe bashkëfinancuar nga Belgjika, Gjermania, Irlanda, Norvegjia dhe Këshilli i Evropës.

Mendimet e shprehura në këtë botim janë përgjegjësi e autorëve dhe nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht politikën zyrtare të Këshillit të Evropës.

Riprodhimi i ekstrakteve (deri në 500 fjalë) është i autorizuar, përveç nëse përdoret për qëllime komerciale për sa kohë ruhet integriteti i tekstit, ekstrakti nuk përdoret jashtë kontekstit, nuk ofron informacion jo të plotë ose ndryshe nuk e çorienton lexuesin për nga natyra, qëllimi ose përmbajtja e tekstit. Teksti burimor duhet të referohet si vijon "© Këshilli i Evropës, viti i botimit". Të gjitha kërkesat tjera në lidhje me riprodhimin / përkthimin e dokumentit të plotë ose një pjese të dokumentit, duhet t'i drejtohen Drejtorisë së Komunikimit, Këshilli i Evropës (F-67075 Strasburg Cedex ose publishing@coe.int).

E gjithë korrespondenca tjetër në lidhje me këtë botim duhet t'i drejtohet Divizionit Nacional të Zbatimit të të Drejtave të Njeriut, Departamenti I Politikës dhe Bashkëpunimit për të Drejtat e Njeriut, Drejtoria e të Drejtave të Njeriut, Drejtoria e Përgjithshme e të Drejtave të Njeriut dhe Sundimi i Ligjit.

Fotografitë
Shutterstock.com

Faqosja dhe dizajni i kopertinës
Piar Creations

@Këshilli i Evropës, shtator 2023

# Tabela e Përmbajtjes


**I. VLERËSIMI I NEVOJAVE TË GJYKATËS KUSHTETUESE PËR MONITORIM TË PËRMBARIMIT TË AKTGJYKIMEVE**

A. Hyrje

B. Informacion bazë për kontekstin ligjor dhe institucional

**II. SHQYRTIMI I STANDARDEVE NDËRKOMBËTARE/EVROPIANE DHE LEGJISLACIONIT TË BRENDSHËM RELEVANTË, AKTEVE NËNLIGJORE DHE RREGULLOREVE TË BRENDSHME TË GJYKATËS**

**A.** Standardet ndërkombëtare/evropiane

**B.** Përvoja nga Gjykatat Rajonale Evropiane

i. Përmbarimi i vendimit të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GjEDNj)

ii. Përmbarimi i vendimeve të Gjykatës së Drejtësisë së Bashkimit Evropian (GjDBE)

**C.** Përvoja nga Gjykatat Kushtetuese Evropiane

i. Forca obliguese e vendimeve të Gjykatës Kushtetuese.

ii. Gama e subjekteve të përfshira në përmbarimin e vendimeve të Gjykatës Kushtetuese.

a. *efekti erga omnes*
b. *inter partes apo institucione të veçanta*

iii. Efekti i përkohshëm i vendimeve të Gjykatës Kushtetuese
iv. Njoftimi dhe publikimi i vendimeve të Gjykatës Kushtetuese

**D.** Korniza ligjore relevante për përmbarimin e vendimeve të Gjykatës Kushtetuese të Kosovës*

i. korniza ligjore relevante për përmbarimin e vendimeve të Gjykatës Kushtetuese të Kosovës*
ii. korniza ligjore relevante për përmbarimin e vendimeve të gjykatave të rregullta të Kosovës*

**E.** Shqyrtimi i praktikës gjyqësore përkatëse të Gjykatës Kushtetuese dhe gjykatave të rregullta

**F.** Mbledhja e të dhënave nga Gjykata Kushtetuese dhe palët e tjera të interesit relevante për përmbarimin e vendimeve të Gjykatës Kushtetuese
(takimet e grupeve punuese online)

**G.** Dialogu ndërmjet Gjykatës Kushtetuese dhe institucioneve të tjera në Kosovë *

**H.** Trajnimi dhe edukimi

**I.** Ndërgjegjësimi i publikut dhe prezantimi i aktgjykimit të ri

## III.PËRFUNDIME DHE REKOMANDIME

i. Rekomandime për marrjen e komenteve mbi përmbarimin nga parashtruesit dhe të anketuarit (palët)

ii. Rekomandim për metodologjitë gjyqësore që do të përdorë Gjykata Kushtetuese

iii. Rekomandime për format e shqyrtimit vjetor ose periodik të përmbarimit të aktgjykimeve

iv. Rekomandime për alokimin e burimeve njerëzore

v. Rekomandim për ngritjen e vetëdijesimit për përmbarimin e vendimeve të Gjykatës Kushtetuese

Shtojcë - Indeksi terminologjik dhe burimet

- **VLERËSIMI I NEVOJAVE TË GJYKATËS KUSHTETUESE PËR MONITORIM TË PËRMBARIMIT TË AKTGJYKIMEVE**

[1] Të gjitha referencat për Kosovën, si për territorin, institucionet apo popullsinë, në këtë tekst duhet të nënkuptohet në pajtim të plotë me Rezolutën 1244 të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara dhe pa paragjykim për statusin e Kosovës.

# Hyrje

Në përputhje me TeR, ky raport është fokusuar në vlerësimin e nevojave të Gjykatës Kushtetuese të Kosovës në monitorimin e përmbarimit të aktgjykimeve. Ky raport ka të bëjë me përmbarimin e aktgjykimeve të gjykatave të rregullta të Kosovës* dhe veçanërisht të aktgjykimeve të Gjykatës Kushtetuese. Kosova* duke mos qenë palë e Këshillit të Evropës dhe as nënshkruese e Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNj), çështja e përmbarimit të vendimeve të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GjEDNj) nga Kosova* nuk është pjesë e këtij raporti.

Për përgatitjen e këtij raporti, konsulentët kanë analizuar legjislacionin vendor, duke përfshirë aktet nënligjore dhe aktet e brendshme të gjykatave, praktikën e tyre gjyqësore, si dhe rregullat dhe procedurat para GjEDNj-së dhe Gjykatës së Drejtësisë së Bashkimi Evropian (GjDBE) dhe materiale të tjera përkatëse për këtë çështje . Konsulentët kanë zhvilluar edhe një sërë intervistash dhe takimesh, personalisht, në Prishtinë dhe në Strasburg, me kryetaren e Gjykatës Kushtetuese, znj. Gresa Caka-Nimani, disa gjyqtarë dhe ish-gjyqtarë të Gjykatës Kushtetuese, znj. Selvete Gërxhaliu. znj. Remzie Istrefi, z. Nexhmi Rexhepi, dhe z. Bekim Sejdiu, dhe anëtarët e stafit të Gjykatës Kushtetuese, z. Jeton Bytyqi. Konsulentët u takuan edhe me Avokatin e Popullit, z. Naim Qelaj, dhe disa anëtarë të stafit të IAP-së. Janë zhvilluar edhe disa konsultime online.

# Informacion bazë për kontekstin ligjor dhe institucional

Rendi juridik vendor, megjithatë, i ka dhënë KEDNj-së një pozitë të privilegjuar. Kushtetuta e Kosovës* i ka dhënë status kushtetues KEDNj-së. Neni 22 i Kushtetutës, i titulluar "Zbatueshmëria e drejtpërdrejtë e marrëveshjeve dhe instrumenteve ndërkombëtare" parasheh se:

> *"Të drejtat e njeriut dhe liritë themelore të garantuara nga marrëveshjet dhe instrumentet e mëposhtme ndërkombëtare janë të garantuara nga kjo Kushtetutë, janë drejtpërdrejt të zbatueshme në Republikën e Kosovës* dhe, në rast konflikti, kanë përparësi ndaj dispozitave të ligjeve dhe akteve të tjera të institucioneve publike:*
>
> …
>
> *(2) Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Liritë Themelore dhe Protokollet e saj;"*

Përveç kësaj, Neni 53 i Kushtetutës së Kosovës*, i titulluar "Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut", parasheh se:

> *"Të drejtat njeriut dhe liritë themelore të garantuara me këtë Kushtetutë, interpretohen në harmoni me vendimet gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut."*

Në këtë kontekst, duke pasur parasysh dispozitën e Nenit 53 të Konventës, të cituar më sipër, dhe interpretimin e GjEDNj-së , është e qartë se çështja e përmbarimit të vendimeve gjyqësore, është pjesë përbërëse e garancive të gjykimit të drejtë, të cilat institucionet e Kosovës* dhe gjyqësori duhet t'i respektojnë. Gjithashtu, çështja e përmbarimit të vendimeve gjyqësore shkon në thelb të efikasitetit të funksionimit të sistemit gjyqësor dhe një shteti të bazuar në sundimin e ligjit. Për këtë qëllim, praktika e GjEDNj-së dhe e institucioneve kombëtare, përfshirë gjyqësorin, nga vendet palë në KEDNj, në përmbarimin e vendimeve gjyqësore kombëtare dhe të GjEDNj-së janë marrë në konsideratë dhe janë frymëzuar në hartimin e këtij raporti.

[2] Për shembull, Komisioni Evropian për Efikasitetin e Drejtësisë (CEPEJ) "Udhëzues i praktikave të mira për përmbarimin e vendimeve gjyqësore" siç u miratua në seancën e 26-të Plenare të CEPEJ-it, 10-11 dhjetor 2015.

# SHQYRTIMI I STANDARDEVE NDËRKOMBËTARE/EVROPIANE DHE LEGJISLACIONIT TË BRENDSHËM RELEVANTË, AKTEVE NËNLIGJORE DHE RREGULLOREVE TË BRENDSHME TË GJYKATËS

# A. Standardet ndërkombëtare/evropiane

Pa qasje efektive në drejtësi nuk ka mbrojtje efektive ligjore të të drejtave të njeriut. Qasje efektiv do të thotë që të gjithë, kudo, duhet të gëzojnë mbrojtjen e barabartë të ligjit nëse do të ketë drejtësi për të gjithë. Në të drejtën ndërkombëtare, ashtu si në të drejtën kombëtare, qasja në drejtësi mund të garantohet vetëm me mjete juridike efektive. Nga këndvështrimi i individit, qasja në drejtësi është qasje në gjykatë e cila është e konstituuar me ligj dhe me garanci për paanshmëri dhe pavarësi në zbatimin e ligjit. Prandaj, ne mund të identifikojmë disa parime që të gjitha sistemet e drejtësisë, civile dhe penale, duhet të përmbushin për të siguruar qasje efektive në drejtësi. Qasja efektive në drejtësi nuk duhet të jetë vetëm në rezultatin që jep, por duhet të jetë e drejtë në mënyrën se si i trajton palët ndërgjyqëse, të ofrojë procedura të përshtatshme me një kosto të arsyeshme, të trajtojë çështjet me shpejtësi të arsyeshme, të jetë e kuptueshme për ata që e përdorin atë, të ofrojë aq siguri sa e mundëson natyra e rastit të veçantë dhe të jetë efektiv, me burime adekuate dhe të organizuara.

Në ratifikimin e Konventës, shtetet kontraktuese marrin përsipër të sigurojnë që ligji i tyre vendor të jetë në përputhje me Konventën. Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut garanton të drejtat dhe liritë themelore të cilat shtetet anëtare ndaj Këshillit të Evropës dhe Konventës (sot 46) janë të detyruara t'i vendosin dhe respektojnë. Drejtësia efektive në nivelin vendor është jashtëzakonisht e rëndësishme dhe për këtë arsye në Nenin 13 të saj, Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut flet për "mjet juridik efektiv" duke theksuar se "Çdokush, të cilit i janë shkelur të drejtat dhe liritë e përcaktuara në Konventë, duhet të ketë mjete ligjore efektive para një organi kombëtar, pavarësisht se shkelja është kryer nga persona që veprojnë në kapacitet zyrtar."

Praktika gjyqësore e GjEDNj-së njeh se shtetet kanë hapësirë të gjerë vlerësimi në përcaktimin e kërkesave procedurale për ushtrimin e së drejtës për drejtësi efektive. Elementi thelbësor është që drejtësia efektive të shfaqet si komponent thelbësor i çdo sistemi të mbrojtjes së të drejtave të njeriut, i cili në parim duhet të mbrohet edhe në kohë krize dhe emergjence. Në këtë drejtim, është detyrim pozitiv i shteteve që të organizojnë sistemin e tyre gjyqësor në një mënyrë që të përmbushë pritshmëritë e qytetarëve për drejtësi efikase dhe të dukshme.

[3] Shih Hornsby k. Greqisë, kërkesa nr. 18357/91, 19 mars 1997.
[4] Lord Lester of Herne Hill QC, Qasja në drejtësi, Interights-Buletin, (Shqyrtim i Qendrës Ndërkombëtare për Mbrojtjen Ligjore të të Drejtave të Njeriut - ISSN 0268-3709 1996 Vëllimi 10 Nr. 2

[5] Master of the Rolls, Lord Woolf, Raport mbi sistemin civil anglez (1996)
[6] Scordino k. Italisë (nr. 1) [GC], kërkesa nr. 36813/97 §§ 232-234 aktgjykimi i datës 29.06.2006.

Krijimi i një gjyqësori të pavarur ka qenë një nga prioritetet kryesore të reformës në proceset e anëtarësimit në BE. Kur bëhet fjalë për efikasitetin e gjyqësorit, mund të vërejmë se neglizhenca dhe investimi i pamjaftueshëm i shumë viteve kanë dëmtuar efikasitetin gjyqësor dhe qasjen në drejtësi në Ballkanin Perëndimor. Në shumicën e vendeve, ka vonesa të gjata gjyqësore dhe një numër të madh lëndësh të prapambetura.

Parimet e lartpërmendura zbatohen në sistemet juridike në Ballkanin Perëndimor, përfshirë Kosovën*. Kosova* i është nënshtruar një procesi sfidues të harmonizimit të ligjeve dhe institucioneve me Konventën dhe direktivat përkatëse të BE-së. Kornizat legjislative dhe administrative dhe praktikat gjyqësore janë përmirësuar më tej dhe përpjekje të konsiderueshme i janë kushtuar zhvillimit të kapaciteteve institucionale dhe rritjes së njohurive. Megjithatë, ka ende shumë për të bërë për të siguruar mënyrat dhe mjetet për zbatimin praktik.

# B. Përvoja nga Gjykatat Rajonale Evropiane

*i. Përmbarimi i vendimit të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GjEDNj)*

Në sistemin e GjEDNj-së neni kryesor që rregullon çështjen e mbikëqyrjes së vendimeve të GjEDNj-së është Neni 46 i Konventës. Ky nen parasheh:

*"Forcë detyruese dhe përmbarim të aktgjykimeve*
*"**1.** *Palët e Larta Kontraktuese marrin përsipër ta respektojnë aktgjykimin e formës së prerë të gjykatës në një rast në të cilin ato janë palë.*
**2.** *Aktgjykimi i formës së prerë i gjykatës bartet tek Komiteti i Ministrave i cili e mbikëqyrë përmbarimin e tij.*
**3.** *Nëse Komiteti i Ministrave vlerëson se mbikëqyrja e përmbarimit të një aktgjykimi të formës së prerë pengohet nga problemi i interpretimit të vendimit, ai mund t'ia referojë çështjen Gjykatës për një vendim mbi çështjen e interpretimit. Vendimi i referimit kërkon shumicën e votave të dy të tretave të përfaqësuesve që kanë të drejtë të marrin pjesë në komitet.*
**4.** *Nëse Komiteti i Ministrave konsideron se një Palë e Lartë Kontraktuese refuzon t'i bindet një vendimi të formës së prerë në një çështje në të cilën është palë, ajo mundet, pasi t'i dërgojë njoftim zyrtar asaj Pale dhe me vendim të miratuar me shumicë votash prej dy të tretave të përfaqësuesve që kanë të drejtë të marrin pjesë në komitet, ia referojnë Gjykatës çështjen nëse ajo Palë ka dështuar të përmbushë detyrimin e saj sipas paragrafit 1.*
**5.** *Nëse Gjykata konstaton shkelje të paragrafit 1, ajo ia referon çështjen Komitetit të Ministrave për shqyrtimin e masave që do të merren. Nëse Gjykata konstaton se nuk ka shkelje të paragrafi 1, ajo ia referon çështjen Komitetit të Ministrave i cili e mbyll shqyrtimin e rastit."*

Nga kjo dispozitë është e qartë se detyra për të mbikëqyrur përmbarimin e vendimeve të GjEDNj-së është e Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës. Regjistruesi do t'u dërgojë drejtpërdrejt kopje palëve, Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Evropës, çdo pale të tretë, duke përfshirë Komisionerin e Këshillit të Evropës për të Drejtat e Njeriut, dhe çdo personi tjetër të interesuar. Kopja origjinale, e nënshkruar siç duhet, do të vendoset në arkivin e Gjykatës.

Për të kryer detyrat e tij, Komiteti i Ministrave ka miratuar rregulla specifike. Me hyrjen në fuqi të protokollit 14 të KEDNj-së, roli i GjEDNj-së përforcohet në këtë drejtim, veçanërisht me futjen e paragrafit 4 të Nenit 46. . Procedura e parashikuar nga kjo dispozitë nxitet nga Komiteti i Ministrave, me vendim të miratuar nga dy të tretat e përfaqësuesve të autorizuar të Komitetit.

Vendimet e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut janë në thelb deklarative në natyrë dhe vetëm në disa rrethana të veçanta Gjykata e ka parë të dobishme t'i tregojë shtetit të paditur llojin e masave që mund të ndërmerren për t'i dhënë fund situatës që ka duke u bërë shkak për konstatimin e shkeljes. Nëse qeveria e paditur ka përmbushur apo jo detyrimet e saj të përcaktuara në vendimin përfundimtar, do të shqyrtohet nga Komiteti i Ministrave dhe nëse është e nevojshme, nga vetë Gjykata. Gjykata nuk ka juridiksion të urdhërojë rihapjen e procedurës si masë. Megjithatë, Gjykata mund të tregojë se një rigjykim ose rihapja e rastit, nëse kërkohet, përbën në parim një mënyrë për të korrigjuar shkeljen .

Për të lehtësuar zbatimin efektiv të vendimeve të saj, Gjykata mund të miratojë një procedurë pilot aktgjykimi që i mundëson asaj të identifikojë qartë në një vendim ekzistimin e problemeve strukturore që qëndrojnë në themel të shkeljeve dhe të tregojë masa ose veprime specifike që duhen ndërmarrë nga shteti i paditur për t'i korrigjuar ato. I takon Komitetit të Ministrave të vlerësojë zbatimin e masave individuale dhe të përgjithshme të parashikuara nga aktgjykimi i Gjykatës.

Në bazë të Nenit 46, Gjykata mund të kërkojë të tregojë llojin e masave individuale dhe/ose të përgjithshme që mund të ndërmerren për t'i dhënë fund situatës që ka gjetur se shkel Konventën. Nëse shkelja e Konventës ndodh ose ka të ngjarë të ndodhë në situata të ngjashme, Gjykata ka konstatuar se masat e përgjithshme në nivel kombëtar ishin padyshim mënyra më e mirë për të parandaluar shkelje të mëtejshme për të gjithë grupin e individëve të prekur nga praktika e konstatuar të jetë në shkelje. Prandaj, masat duhet të jenë të tilla që të korrigjojnë konstatimin e Gjykatës për shkelje në lidhje me një praktikë të përgjithshme, në mënyrë që sistemi i vendosur nga Konventa të mos rrezikohet nga shumë kërkesa të përsëritura që rrjedhin nga i njëjti shkak.

Është e rëndësishme që shtetet të lejohen të vendosin dhe t'u japin efekt masave më të përshtatshme të përmbarimit. Kjo praktikë çon në lehtësimin e detyrës së Komitetit të Ministrave dhe departamentit të përmbarimeve dhe bazohet në parimin e subsidiaritetit. Në këtë drejtim, Gjykata do t'i lërë hapësirë Komitetit të Ministrave në ushtrimin e juridiksionit të vet dhe shteteve në zgjedhjen e masave të duhura përmbarimore.

[7] Shih Rregullat e Komitetit të Ministrave për mbikëqyrjen e përmbarimit të vendimeve dhe të kushteve të marrëveshjeve miqësore (Miratuar nga Komiteti i Ministrave më 10 maj 2006 në mbledhjen e 964-të të Zëvendësministrave dhe ndryshuar më 18 janar 2017 në mbledhjen e 1275-të të Zëvendësministrave dhe më 6 korrik 2022 në mbledhjen e 1439-të të Zëvendësministrave)
[8] Shih Ilgar Mammadov k. Azerbajxhanit, kërkesa nr. 15172/13, [GC], 29/05/2019 dhe Kavala k. Turqisë, kërkesa nr. 28749/18, [GC] 11/07/2022.

[9] Shih Moreira Ferreira k. Portugalisë (nr. 2) [GC], 2017, §§ 49 dhe 51, dhe Guðmundur Andri Ástraðsson k. Islandës [GC], 2020, §§ 311-314

I takon Komitetit të Ministrave të mbikëqyrë miratimin e masave që janë të realizueshme, në kohë, të përshtatshme dhe të mjaftueshme për të siguruar dëmshpërblimin maksimal të mundshëm për shkeljet e konstatuara nga Gjykata. . Procesi i përmbarimit ka të bëjë me pajtueshmërinë nga pala kontraktuese me detyrimet e saj në të drejtën ndërkombëtare sipas Konventës. Këto detyrime bazohen në parimet e së drejtës ndërkombëtare në lidhje me ndërprerjen, mospërsëritjen dhe dëmshpërblimin .

Nëse Komiteti i Ministrave vlerëson se mbikëqyrja e përmbarimit të një aktgjykimi të formës së prerë pengohet nga problemi i interpretimit të vendimit, ai mund t'ia referojë çështjen Gjykatës për një vendim mbi çështjen e interpretimit. Vendimi i referimit do të kërkojë shumicën e votave të dy të tretave të përfaqësuesve që kanë të drejtë të marrin pjesë në komitet. Nëse Komiteti i Ministrave konsideron se një Palë e Lartë Kontraktuese refuzon t'i bindet një vendimi të formës së prerë në një çështje në të cilën është palë, ajo mundet, pasi t'i dërgojë njoftim zyrtar asaj Pale dhe me vendim të miratuar me shumicë votash prej dy të tretave të përfaqësuesve që kanë të drejtë të marrin pjesë në komitet, ia referojnë Gjykatës çështjen nëse ajo Palë ka dështuar të përmbushë detyrimin e saj nga aktgjykimi përfundimtar. Nëse Gjykata konstaton shkelje, ajo ia referon rastin Komitetit të Ministrave për shqyrtimin e masave që do të merren. Nëse Gjykata konstaton se nuk ka shkelje, ajo ia referon rastin Komitetit të Ministrave i cili e mbyll shqyrtimin e rastit.

Neni 46, i ndryshuar nga Protokolli nr. 14, njeh se Gjykata ka një rol plotësues për të luajtur në procesin e përmbarimit. Mekanizmi i mbikëqyrjes sipas Nenit 46 të Konventës ofron kornizë gjithëpërfshirëse për përmbarimin e aktgjykimeve të Gjykatës, të përforcuar nga praktika e Komitetit të Ministrave. Gjykata rithekson se, sipas praktikës gjyqësore të saj të vendosur, zgjedhja përfundimtare e masave që duhen marrë për përmbarimin e një aktgjykimi mbetet tek shtetet nën mbikëqyrjen e Komitetit të Ministrave, me kusht që masat të jenë në përputhje me "konkluzionet dhe frymën" e përcaktuar në aktgjykimin e Gjykatës .

Megjithatë, edhe para hyrjes në fuqi të paragrafit 4 të Nenit 46, GjEDNj-ja është përfshirë në përmbarimin e aktgjykimeve të veta, duke e obliguar Gjykatën në Strasburg të mbajë qëndrime për shkak të pretendimit të mospërmbarimit të aktgjykimeve të saj të mëparshme. Vendimet e fundit të Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës tregojnë se çështja e përmbarimit të vendimeve të GjEDNj-së mbetet çështje delikate, shpesh e prirur ndaj vullnetit politik të shteteve anëtare.

[10] Shih Greens dhe M.T. k. Mbretërisë së Bashkuar, 2010, § 107
[11] Shih Suso Musa k. Maltës, kërkesa nr. 42337/12 § 120, 23.07.2013.
[12] Shih Baybaşin k. Holandës, kërkesa nr. 13600/02, § 79, 06.07.2006.
[13] Shih Ilgar Mammadov k. Azerbajxhanit [GC], 2019, § 155
[14] Rregulli 6.2 i Rregullores së Komitetit të Ministrave, shih edhe Ilgar Mammadov k. Azerbajxhanit [GC], 2019, §§ 161-162)

*ii. Përmbarimi i vendimeve të Gjykatës së Drejtësisë së Bashkimit Evropian (GjDBE)*

Për sa i përket efektit detyrues të aktgjykimeve të GjDBE-së, neni përkatës i TFBE-së parasheh:

> *"Neni 280 (ish-neni 244 TKE)*
> *Aktgjykimet e Gjykatës së Drejtësisë së Bashkimit Evropian do të jenë të përmbarueshme sipas kushteve të përcaktuara në Nenin 299."*

Përveç kësaj, Rregullorja e Punës së Gjykatës së Drejtësisë parasheh që:

> *"Neni 91 – Natyra obligative e aktgjykimeve dhe urdhrave*
> *1. Aktgjykimi është obligativ nga data e dorëzimit të tij.*
> *2. Urdhri është obligativ nga data e shërbimit të tij."*

Në sistemin e BE-së çështja e përmbarimit të aktgjykimeve i besohet Komisionit Evropian. Kjo parashikohet qartë nga Neni 260 § 2 i TFBE-së i cili formulohet si më poshtë:

> "Neni 260 (ish-neni 228 TKE)
>
> *Nëse Komisioni konsideron se shteti anëtar në fjalë nuk ka marrë masat e nevojshme për të zbatuar aktgjykimin e Gjykatës, ai mund ta çojë rastin përpara Gjykatës pasi t'i japë atij shteti mundësinë për të paraqitur vërejtjet e tij. Ai do të specifikojë shumën e shumës fikse ose pagesës së gjobës që duhet paguar nga shteti anëtar në fjalë, të cilën e konsideron të përshtatshme në ato rrethana. Nëse Gjykata konstaton se shteti anëtar në fjalë nuk e ka zbatuar aktgjykimin e tij, ajo mund të vendosë një shumë fikse ose një pagesë gjobë.*

Është e rëndësishme të theksohet se GjDBE-ja ka ndërhyrë në mënyrë efektive, duke vendosur gjoba të konsiderueshme ndaj shteteve anëtare të BE-së, në rastet e moszbatimit të aktgjykimeve ose urdhrave të saj. .

[15] Shih Ilgar Mammadov k. Azerbajxhanit (procedura për shkelje) [KP], nr. 15172/13, § 182, aktgjykim i datës 29 maj 2019.
[16] Shih për shembull Verein Gegen Tierfabriken Schweiz (VgT) k. Zvicrës (Nr. 2), kërkesa nr. 32772/02, [GC], 30/06/2009, Jeronovičs k. Letonisë kërkesa nr. 44898/10, [GC], 05/07/2016, Emre k. Zvicrës (nr. 2), kërkesa nr. 5056/10, 11/10/2011.
[17] Shih vendimin H46-27 Kavala k. Turqisë (Kërkesa nr. 28749/18), Mbledhja 1459, 7-9 mars 2023 (DH) dhe Rezoluta e Përkohshme CM/ResDH(2023)36, Selahattin Demirtaş (Nr. 2) k. Turqisë, (miratuar nga Komiteti i Ministrave më 9 mars 2023, në mbledhjen e 1459-të të Zëvendësministrave).
[18] Shih Traktatin mbi Funksionimin e Bashkimit Evropian (TFBE), në C 115/176 EN Gazeta Zyrtare e Bashkimit Evropian 9.5.2008.
[19] L 265/2 Gazeta Zyrtare e Bashkimit Evropian 29.9.2012

# C.Përvoja nga gjykatat kushtetuese evropiane

Tipologjia e gjykatave kushtetuese në shtetet e tjera anëtare të Këshillit të Evropës është mjaft variabile. Kështu janë edhe procedurat e ankesave kushtetuese. Megjithatë, çështja e përmbarimit të aktgjykimeve të gjykatave kushtetuese ka qenë një çështje shqetësuese për shumë dekada dhe për këtë qëllim ka qenë objekt studimesh dhe analizash nga organe të ndryshme të Këshillit të Evropës. Disa elementë të identifikuar në studime të tilla mund të shërbejnë si shembuj të praktikave të mira për Gjykatën Kushtetuese të Kosovës* në përpjekjen për të garantuar përmbarimin e plotë të aktgjykimeve të tyre. Elementët e mëposhtëm mund të identifikohen:

**i. Forca obliguese e vendimeve të Gjykatës Kushtetuese.**

Ka një tendencë midis shumë shteteve anëtare të Këshillit të Evropës për të deklaruar se vendimet e Gjykatës Kushtetuese janë të detyrueshme. Këtë e parasheh edhe Kushtetuta e Republikës Çeke , Hungarisë dhe Sllovakisë . Në Bosnje dhe Hercegovinë kjo parashihet qartë me Kushtetutën dhe Rregulloren e Gjykatës . Në Kroaci këtë e parasheh Ligji për Gjykatën Kushtetuese. Edhe në Azerbajxhan tregohet qartë se vendimet e Gjykatës Kushtetuese janë të detyrueshme. Gjithashtu, është Gjykata Kushtetuese ajo që ndjek përmbarimin e tyre në bazë të raporteve vjetore ose gjashtëmujore dhe informon institucionet e tjera të shtetit kur është e nevojshme. Përmbarimi i aktgjykimit ose opinionit i njoftohet Gjykatës Kushtetuese të Moldavisë në kushtet e përcaktuara në të. Më pas, sekretariati i Gjykatës Kushtetuese ndjek gjendjen e përmbarimit të vendimeve të Gjykatës Kushtetuese. Mjaft interesante, në Belgjikë, Neni 115 i Ligjit për Gjykatën e Arbitrazheve shpall se vendimet e saj janë përmbaruese me ligj. Kjo dispozitë nënvizon se është Mbreti ai që garanton përmbarimin e këtyre vendimeve. Kjo do të thotë se të gjitha kompetencat e organeve shtetërore dhe të gjitha mjetet juridike në dispozicion, mund të përdoren për përmbarimin e tillë. E njëjta gjë mund të shihet edhe në Austri. Si rezultat i një sistemi të tillë, masat antikushtetuese mund të anulohen me efekt të menjëhershëm .

[20] Shih edhe Nenin [299] (ish-neni [256] TKE), i cili parasheh:
"Aktet e Këshillit, Komisionit ose Bankës Qendrore Evropiane që vendosin obligim monetar ndaj personave përveç shteteve, do të jenë të përmbarueshme. Përmbarimi do të rregullohet nga rregullat e procedurës civile në fuqi në shtetin në territorin e të cilit kryhet. Urdhri për përmbarimin e tij do t'i bashkëngjitet vendimit, pa formalitet tjetër përveç verifikimit të autenticitetit të vendimit, nga autoriteti kombëtar që qeveria e çdo shteti anëtar të caktojë për këtë qëllim dhe ia bën të ditur Komisionit dhe Gjykatës së Drejtësisë së Bashkimit Evropian. Kur këto formalitete janë kryer me kërkesë të palës së interesuar, kjo e fundit mund të vazhdojë me përmbarimin në përputhje me legjislacionin kombëtar, duke e çuar çështjen drejtpërdrejt përpara autoritetit kompetent. Përmbarimi mund të pezullohet vetëm me vendim të Gjykatës. Megjithatë, gjykatat e vendit në fjalë do të kenë juridiksion mbi ankesat se përmbarimi po kryhet në mënyrë të parregullt."

[21] Shih Urdhrin e Zëvendëspresidentit të Gjykatës, të [27] tetorit [2021], në Rastin C-[204]/[21] R Komisioni k. Polonisë duke urdhëruar që:
"Meqenëse nuk e ka pezulluar zbatimin e dispozitave të legjislacionit kombëtar që kanë të bëjnë, veçanërisht, me fushat e juridiksionit të Dhomës Disiplinore të Gjykatës së Lartë, Polonia urdhërohet t'i paguajë Komisionit Evropian një gjobë ditore në shumën [1 000 000]€. Pajtueshmëria me masat e përkohshme të urdhëruara më [14] korrik [2021] është e nevojshme për të shmangur dëme serioze dhe të pariparueshme për rendin juridik të Bashkimit Evropian dhe për vlerat mbi të cilat është themeluar ai Union, veçanërisht ai i sundimit të ligjit"

# C. Përvoja nga gjykatat kushtetuese evropiane

## ii. Gama e subjekteve të përfshira në përmbarimin e vendimeve të Gjykatës Kushtetuese.

### *a. efekti erga omnes*

Hulumtimi tregon se përgjithësisht vendimet e gjykatave kushtetuese në shumicën e shteteve evropiane kanë efekt erga omnes . Kështu ndodh gjithmonë pas shpalljes së pavlefshme ose anulimit të një akti legjislativ, kur ka pasur shqyrtim paraprak ose shqyrtim abstrakt. Më pas dispozita shfuqizohet. Efekti erga omnes shtrihet në disa shtete në të gjitha vendimet që kanë të bëjnë me antikushtetutshmërinë e një mase legjislative, veçanërisht në kontekstin e një referimi për një vendim paraprak ose të një veprimi të drejtpërdrejtë përpara gjykatës kushtetuese . Në shumë shtete efekti erga omnes parashihet qartë në ligj . Madje, në një sërë shtetesh parashikohet që vendimet e gjykatës kushtetuese të kenë fuqinë e ligjit. Në Austria, aktgjykimet në lidhje me ndarjen e kompetencave në parim barazohen me ligjin kushtetues. Në disa shtete të tjera, institucionet kompetente duhet të miratojnë masa, veçanërisht ato legjislative, në mënyrë që të jenë në përputhje me vendimin. Kështu ndodh edhe në Francë  dhe në Republikën Çeke  Në Sllovaki, ligjvënësi duhet të harmonizojë legjislacionin me Kushtetutën brenda një periudhe gjashtëmujore nga vendimi i Gjykatës Kushtetuese. Në disa vende, këtyre autoriteteve u kërkohet t'i miratojnë ato masa brenda një afati kohor të përcaktuar nga Gjykata Kushtetuese . Në disa raste të tjera autoritetet përgjegjëse varen nga natyra e detyrimit që rrjedh nga vendimi i Gjykatës Kushtetuese .

[22] Shih Nenin [89] të Kushtetutës së Republikës Çeke.
[23] Neni [51] i Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Hungarisë.
[24] Neni [128(1)] i Kushtetutës së Sllovakisë.
[25] Neni VI.[4] i Kushtetutës së Bosnjës dhe Hercegovinës parasheh:
"Vendimet e Gjykatës Kushtetuese janë përfundimtare dhe detyruese."
[26] Shih Rregulloren e Punës së Gjykatës Kushtetuese të Bosnjës dhe Hercegovinës
Neni [72] (Natyra Detyruese. Mënyra e Përmbarimit dhe Afati i Përmbarimit)
"(1) Vendimet e Gjykatës Kushtetuese janë përfundimtare dhe detyruese. Çdo person fizik dhe juridik obligohet t'i zbatojë ato.
(2) Të gjitha organet obligohen që vendimet e Gjykatës Kushtetuese t'i përmbarojnë në kuadër të kompetencave të tyre të përcaktuara me Kushtetutë dhe ligj.
(3) Çdo person që ka interes juridik mund të kërkojë përmbarimin e vendimit të Gjykatës Kushtetuese.
(4) Gjykata Kushtetuese në vendimin e saj mund të caktojë mënyrën dhe afatin për përmbarimin e vendimit të Gjykatës Kushtetuese.
(5) Organi i obliguar për përmbarimin e vendimit të Gjykatës Kushtetuese në afatin nga paragrafi (4) i këtij neni obligohet që të paraqesë informata për masat e marra për përmbarimin e vendimit të Gjykatës Kushtetuese, siç kërkohet me vendim.
(6) Në rast të mospërmbarimit të vendimit, ose vonesës së përmbarimit ose informimit të Gjykatës Kushtetuese për masat e marra, Gjykata Kushtetuese merr aktvendim me të cilin konstaton se vendimi i saj nuk është përmbaruar dhe mund të përcaktojë mënyrën e përmbarimit të vendimit. Ky aktvendim i transmetohet prokurorit kompetent ose organit tjetër kompetent për përmbarimin e vendimit të caktuar nga Gjykata Kushtetuese."
[27] Nen. [30.] i ligjit Kushtetues për Gjykatën Kushtetuese parasheh:
"(1) Vendimet dhe aktvendimet e Gjykatës Kushtetuese janë të detyrueshme dhe çdo person fizik apo juridik duhet t'u bindet atyre.
(2) Të gjitha organet e pushtetit qendror dhe të vetëqeverisjes dhe administratës lokale, në kuadër të kompetencave të tyre kushtetuese dhe juridike, i zbatojnë vendimet dhe aktvendimet e Gjykatës Kushtetuese.
(3) Qeveria e Republikës së Kroacisë siguron, nëpërmjet organeve të administratës qendrore, përmbarimin e vendimeve dhe aktvendimeve të Gjykatës Kushtetuese.
(4) Gjykata Kushtetuese mund të caktojë se cili organ autorizohet për përmbarimin e vendimit të saj, përkatësisht aktvendimit.

### *b. inter partes apo institucione të veçanta*

Përkundrazi, shqyrtimi i kushtetutshmërisë së vendimeve individuale, përfshirë rastet që përfshijnë një referim për një vendim paraprak për sa i përket vlefshmërisë së dispozitave, shpesh rezulton në aktgjykime, fushëveprimi i të cilave është thjesht inter partes. Megjithatë, efekti inter partes i vendimeve të tilla nuk i pengon viktimat e zbatimit të masave antikushtetuese të kërkojnë rihapjen e procedurave ose të kërkojnë dëmshpërblim , ose duke çuar në pasoja më të gjera në praktikë . Në Bosnje, për shembull, ofrohet mundësia që çdo person që ka interes ligjor të kërkojë përmbarimin e një vendimi të Gjykatës Kushtetuese. Në Spanjë, vendimet që kanë të bëjnë me mbrojtjen e të drejtave kushtetuese në parim kanë efekt inter partes, por interpretimi i dhënë nga Gjykata Kushtetuese është i detyrueshëm për gjykatat e tjera dhe për ndryshimin e praktikës gjyqësore nevojitet pajtimi i gjykatës në përbërje të plotë. Përveç kësaj, nëse një ligj bie ndesh me të drejtat themelore ose liritë publike, ai mund t'i nënshtrohet shqyrtimit në mënyrë abstrakte. .

Ka shumë shembuj që tregojnë se shumë Gjykata Kushtetuese në Evropë i drejtojnë një kërkesë një institucioni të caktuar për të miratuar një akt të caktuar ose për të vepruar në një mënyrë specifike, në mënyrë që të respektojnë vendimin e Gjykatës Kushtetuese. Në disa shtete, gjykata kushtetuese ka kompetenca të gjera dhe mund të japë të gjitha urdhrat e nevojshëm për përmbarimin e vendimeve, duke përfshirë dhënien e udhëzimeve për autoritetet e tjera. Në Bosnjë, Gjykata Kushtetuese në vendimin e saj mund të caktojë mënyrën dhe afatin për përmbarimin e vendimit të Gjykatës Kushtetuese. Ky është rasti edhe në Slloveni, "Gjykata Kushtetuese, sipas nevojës, përcakton institucionin përgjegjës për zbatimin dhe kushtet për zbatimin e vendimit. Gjykata Kushtetuese e Ukrainës, "mund të përcaktojë në vendimin ose opinionin e saj procedurat që duhen ndjekur për t'i dhënë efekt dhe të detyrojë institucionet kompetente të shtetit të zbatojnë vendimin për t'iu përmbajtur opinionit"

Natyra e urdhrave të dhëna nga Gjykatat Kushtetuese Evropiane, ndryshojnë në natyrë. Ato mund të konsistojnë në urdhrimin e ligjvënësit për të ndryshuar një dispozitë ligjore , edhe brenda një kohe të caktuar, ose duke dhënë njoftim për këtë, ose duke urdhëruar lirimin e një të paraburgosuri, duke urdhëruar rihapjen e procedurave penale që shkaktuan sanksion me efekte negative të vazhdueshme .

Kur Gjykata Kushtetuese vendos në kontekstin e një padie të drejtpërdrejtë të ngritur nga një individ për shkelje të të drejtave kushtetuese, ajo ose mund të vendosë për themelin e rastit ose t'ia kthejë rastin një autoriteti inferior për një vendim të ri, gjë që duket të jetë zgjidhja më e shpeshtë në raste të tilla. Në rastin e mëvonshëm, çështja e përmbarimit të vendimit të Gjykatës Kushtetuese mbetet në gjykatat e rregullta.

### *iii. Efekti i përkohshëm i vendimeve të Gjykatës Kushtetuese*

Kur kryhet shqyrtim paraprak, kjo, sipas përkufizimit, pengon hyrjen në fuqi të dispozitës. Efekti i aktgjykimit është se ligji nuk publikohet . Nëse vetëm një pjesë e tekstit të kontestuar shpallet jokushtetuese, pjesa tjetër hyn në fuqi. Pavlefshmëria zakonisht hyn në fuqi në datën në të cilën vendimi është dhënë ose publikuar (efekti ex nunc) ose menjëherë më pas. Shtetet në të cilat pavlefshmëria në mënyrë sistematike hyn në fuqi në mënyrë retroaktive (ex tunc) janë përjashtim: në këtë rast, pavlefshmëria e një mase legjislative nuk zbatohet vetëm për procedurat në vazhdim e sipër dhe për procedurat që janë duke u zhvilluar në datën e aktgjykimit, por edhe për disa procedura të cilat tashmë janë mbyllur. .

Në shtete të tjera, Gjykata Kushtetuese mund të përcaktojë që vendimi i saj ka efekt prapaveprues në raste specifike. Vendimet e Gjykatës Kushtetuese spanjolle kanë fuqi prapavepruese kur moszbatimi i dispozitës antikushtetuese do të rezultonte me një sanksion penal ose administrativ më pak të rëndë ose pa sanksion fare. Në disa vende vendimet në çështjet penale të cilat bazohen në një dispozitë jokushtetuese mund të rishikohen. Në Slloveni, Gjykata Kushtetuese mund të vendosë që një vendim të ketë fuqi prapavepruese kur anulohen rregulloret e miratuara për ushtrimin e pushteteve publike; një palë e prekur negativisht nga një vendim i marrë në bazë të një mase të tillë ka të drejtë, në kushte të caktuara, të kërkojë ndryshimin ose anulimin e kësaj mase.

Në shumë shtete, data në të cilën vendimi hyn në fuqi mund të shtyhet, në mënyrë që t'u jepet autoriteteve kohë për të përshtatur legjislacionin për t'iu përshtatur vendimit të Gjykatës. Kjo ndodh veçanërisht kur, pas një deklarate të antikushtetutshmërisë, janë të mundshme disa zgjidhje në përputhje me Kushtetutën, kur aktgjykimi ka implikime të mëdha buxhetore ose nevojiten konsultime politike.

[31]Shih Nenin [89] të Kushtetutës së Republikës Çeke.

[32] Shih Nenin [22] të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Bullgarisë. Nenin [27] § [2] të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Hungarisë dhe Nenin [190] § [1] të Kushtetutës së Polonisë.

[33] Shih Nen. [30] të Aktit Kushtetues të Gjykatës Kushtetuese në Kroaci:

"[1] Vendimet dhe aktvendimet e Gjykatës Kushtetuese janë të detyrueshme dhe çdo person fizik apo juridik duhet t'u bindet atyre.

[2.] Të gjitha organet e pushtetit qendror dhe të vetëqeverisjes dhe administratës lokale, në kuadër të kompetencave të tyre kushtetuese dhe juridike, i zbatojnë vendimet dhe aktvendimet e Gjykatës Kushtetuese.

[3.] Qeveria e Republikës së Kroacisë siguron, nëpërmjet organeve të administratës qendrore, përmbarimin e vendimeve dhe aktvendimeve të Gjykatës Kushtetuese.

[4.] Gjykata Kushtetuese mund të caktojë se cili organ autorizohet për përmbarimin e vendimit të saj, përkatësisht aktvendimit."

### *iv. Njoftimi dhe publikimi i vendimeve të Gjykatës Kushtetuese*

Në shumicën e shteteve, vendimet e Gjykatës Kushtetuese ose të organit ekuivalent publikohen në një gazetë zyrtare. Për shembull, në Bosnje dhe Hercegovinë aktgjykimi publikohet në Gazetën Zyrtare të Bosnjës dhe Hercegovinës dhe entiteteve përbërëse të saj. Kështu është edhe në Estoni, Francë, Hungari, Itali . Në Poloni, vendimet publikohen në organin në të cilin është shpallur masa e kontestuar dhe, në mungesë të një organi të tillë, në gazetën zyrtare. Në Belgjikë, është interesante të theksohet se, një formulë shtohet nga Kancelari i Gjykatës në fund të secilit vendim.

Praktika e Gjykatës Kushtetuese sllovene, ndër të tjera, është mjaft interesante në këtë drejtim. Në raportet e saj vjetore mbi aktivitetet e Gjykatës, një kapitull i veçantë i kushtohet "Respektimit të vendimeve të Gjykatës Kushtetuese". Ky është me të vërtetë kapitulli i parë i raporteve vjetore të Gjykatës Kushtetuese të Sllovenisë, shenjë që tregon rëndësinë që i jepet kësaj çështjeje nga ajo gjykatë.

[34] Shih Nenin [72] **§** [2] të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Lituanisë.
[35] Shih Nenin [72(3)] të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Lituanisë.
[36] Shih Nenin [62(2)] të Kushtetutës Franceze.
[37] Neni [89] i Kushtetutës së Republikës Çeke.
[38] Shih Nenin [132] të Kushtetutës së Sllovakisë.
[39] Neni [59] i Rregullores së Punës së Gjykatës Kushtetuese të Bosnjës dhe Hercegovinës.
[40] Për shembull, në Itali, është Prokurori i Përgjithshëm ai që, pas një vendimi të Gjykatës Kushtetuese, urdhëron lirimin e çdo të ndaluari në bazë të një ligji antikushtetues.
[41] Kështu është rasti në Danimarkë për shembull.
[42] Në Belgjikë, vetëm aktgjykimet mbi një kërkesë abstrakte kanë efekt erga omnes, ndërsa ato që rrjedhin nga një kërkesë prej një gjykate të zakonshme kanë efekt inter partes. Megjithatë, pas një vendimi antikushtetues për një masë legjislative, Këshilli Federal i Ministrave ose një qeveri komunitare ose rajonale ka gjashtë muaj kohë për të kërkuar anulimin e masës si të tillë nga Gjykata Kushtetuese. Neni [4(2)] i Ligjit Special belg për Gjykatën e Arbitrazhit

Council of Ministers or a Community or Regional Government has six months in which to request the annulment of the measure as such by the Constitutional Court. Article [4(2)] of the Belgian Special Law on the Court of Arbitration
[43] Shih Nenin [72] **§** [3] të Rregullores së Punës së Gjykatës Kushtetuese të Bosnjës dhe Hercegovinës e cila thotë: "[(3)] Çdo person që ka interes juridik mund të kërkojë përmbarimin e vendimit të Gjykatës Kushtetuese."
[44] Neni [55] i Ligjit Organik për Gjykatën Kushtetuese.
[45] Shih Nenin [46] **§** [2] të Kushtetutës së Maltës.
[46] Shih Nenin [72] **§** [4] të Rregullores së Punës së Gjykatës Kushtetuese.
[47] Shih nenet [40] **§** [2] dhe [60] **§** [2] të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Sllovenisë.
[48] Neni [70] i Ligjit për Gjykatën Kushtetuese.
[49] Kështu është rasti në Hungari.
[50] Kështu është rasti në Gjermani.
[51] Kështu është rasti në Itali.
[52] Kështu është rasti në Zvicër.
[53] Neni [43(3)] i Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Hungarisë.
[54] Shih për shembull Nenin [57] të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Sllovakisë dhe Nenin [60] të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Sllovenisë.

[55] Neni [43(3)] i Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Hungarisë.
[56] Shih për shembull Nenin [8] ss të Ligjit Special për Gjykatën e Arbitrazhit në Belgjikë dhe Nenin [282] të Kushtetutës Portugeze.
[57] Shih Nenin [51] **§** [1] dhe [4] të Ligjit për Gjykatën Speciale Supreme në Belgjikë.
[58] Neni [40] i Ligjit Organik për Gjykatën Kushtetuese të Spanjës. Shih edhe nenet [43] **§§** [3,4] të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Hungarisë.
[59] Neni [79] i Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Gjermanisë dhe Neni [26] i Ligjit për Organizimin dhe Operimin e Gjykatës Kushtetuese të Sllovenisë.
[60] Shih nenet [45] dhe [46] të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Sllovenisë.
[61] Për shembull, në Itali ekziston një praktikë që Gjykata Kushtetuese mund të vendosë për një datë të shtyrë për hyrjen në fuqi të vendimeve të saj. Në Slloveni, Gjykata Kushtetuese ka të drejtë me ligj të vendosë për një datë të tillë. [Neni [48] i Ligjit për Gjykatën Kushtetuese]. Kështu është rasti në Bosnjë. [Neni [72] **§** [4] i rregullave të Gjykatës] dhe në Republikën Çeke. [Neni [70] i Ligjit për Gjykatën Kushtetuese]. ku Gjykatat Kushtetuese janë të lira të vendosin datën në të cilën do të merren aktgjykimet e saj hyn në fuqi. Në Poloni, Kushtetuta parasheh që "aktgjykimet e Gjykatës Kushtetuese hyjnë në fuqi në datën e publikimit të tyre". Megjithatë, Gjykata mund të përcaktojë një datë tjetër për anulimin e aktit legjislativ të shpallur jokushtetues. Kjo kohë nuk mund të kalojë [18] muaj në rastin e ligjit dhe [12] muaj në rastin e masave të tjera legjislative. [Shih Nenin [190] **§** [2] të Kushtetutës Polake].

# D. Korniza ligjore relevante për përmbarimin e vendimeve të vendimeve të Gjykatës Kushtetuese të Kosovës

### *i. korniza ligjore relevante për përmbarimin e vendimeve të Gjykatës Kushtetuese të Kosovës*

Gjykata Kushtetuese e Kosovës* është themeluar në vitin 2009, pas përgatitjes së kornizës ligjore nga një grup ekspertësh vendor dhe ndërkombëtarë. Themelimi, përbërja dhe funksionimi i Gjykatës Kushtetuese të Kosovës janë të rregulluara në Kapitullin VIII të Kushtetutës, të titulluar 'Gjykata Kushtetuese' dhe përbëhet nga 7 nene. Gjykata Kushtetuese përbëhet nga 9 gjyqtarë të zgjedhur nga Kuvendi për një mandat 9-vjeçar dhe deri në vitin 2016 ka përfshirë në radhët e saj gjyqtarë ndërkombëtarë.

Dispozita kushtetuese që është përkatës për qëllimet e këtij studimi përfshihen në Nenin 116 . Ky nen, i cili trajton në mënyrë të veçantë efektin juridik të vendimeve të Gjykatës Kushtetuese, parashikon konkretisht:

> *"1. Vendimet e Gjykatës Kushtetuese janë të detyrueshme për gjyqësorin dhe të gjithë personat dhe institucionet e Republikës së Kosovës*.*
>
> *2. Ndërsa procedura është në zhvillim e sipër pranë Gjykatës Kushtetuese, Gjykata mund të pezullojë përkohësisht veprimin ose ligjin e kontestuar derisa Gjykata të marrë një vendim nëse Gjykata konstaton se zbatimi i veprimit ose ligjit të kontestuar të do të rezultonte në dëme të pariparueshme.*
>
> *3. Nëse me vendim të Gjykatës Kushtetuese nuk parashikohet ndryshe, shfuqizimi i ligjit ose aktit ose veprimi tjetër hyn në fuqi ditën e publikimit të vendimit të Gjykatës.*
>
> *4. Vendimet e Gjykatës Kushtetuese publikohen në Gazetën Zyrtare."*

[62] Neni [71] i Rregullores së Punës së Gjykatës.
[63] Neni [24(1)] i Ligjit për Procedurë të Gjykatave për Shqyrtim Kushtetues.
[64] Neni [20] i Urdhrit që inkorporon një Ligji Organik për Gjykatën Kushtetuese.
[65] Neni [41] i Ligjit për Gjykatën Kushtetuese.
[66] Shih në veçanti Nenin [30] të Ligjit nr. [87] të vitit [1953].
[67] Neni [190] § [2] i Kushtetutës.
[68] Kjo formulë parasheh:
"Ministrat anëtarët e Qeverive të Rajoneve dhe Komuniteteve dhe autoriteteve administrative për sa u takon atyre kërkohet që të parashikojnë përmbarimin e këtij aktgjykimi. Përmbaruesit për këtë kërkesë duhet të kontribuojnë në të në lidhje me mjetet e së drejtës zakonore"

[69] Shih respektivisht për raportet e vitit [2020] dhe [2021]: https://www.us.rs.si/wp-content/uploads/[2021]/07/RSUS_LetnoPorocilo_[2020]_EN.pdf dhe https://www.us.rs.si/wp-content/uploads/[2022]/[1]/RSUS_LetnoPorocilo_[2021]_Web_ENG.pdf.
[70] Këto nene rregullojnë përkatësisht: Neni [112] [Parimet e Përgjithshme]; Neni [113] [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara]; Neni [114] [Përbërja dhe Mandati i Gjykatës Kushtetuese]; Neni [115] [Organizimi i Gjykatës Kushtetuese]; Neni [116] [Efekti Juridik i Vendimeve]; Neni [117] [Imuniteti]; dhe Neni [118] [Shkarkimi].

Nga kjo dispozitë duket qartë se ekziston garancia kushtetuese që vendimet e Gjykatës Kushtetuese të Kosovës janë të detyrueshme për të gjithë operatorët ligjorë në vend. Kjo dispozitë mund të konsiderohet si rregullim i mjaftueshëm ligjor sa i përket përmbarimit të aktgjykimeve të Gjykatës Kushtetuese, pasi Ligji Nr. 03/L-121 'Për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës*' nuk përmban dispozitë hartuar në terme të ngjashme.

Janë vetëm dy dispozita të ligjit për Gjykatën Kushtetuese që duket se kontribuojnë në përmbarimin e vendimit të Gjykatës Kushtetuese. E para është dispozita e Nenit 20 të ligjit në fjalë dhe veçanërisht paragrafi 5 i tij që parasheh:

*5.Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare, përveç rastit kur Gjykata Kushtetuese në vendim e ka përcaktuar ndryshe."*

E dyta është përfshirë në Nenin 36 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese i cili rregullon efektin e pezullimit në procedurat e përcaktuara në Nenin 113, paragrafi 3 pika 4 e Kushtetutës. Neni 36 i Ligjit për Gjykatën Kushtetuese parasheh:

*" Kërkesa e paraqitur në përputhje e Nenin 113, paragrafi 3 pika 4 e Kushtetutës, ka efekt pezullues. Kuvendi i Republikës së Kosovës* vepron sipas amendamentit të kontestuar vetëm pasi të jetë marrë vendimi i Gjykatës Kushtetuese."*

Kjo dispozitë e mëvonshme sugjeron që Kuvendi të veprojë në përputhje me vendimin e Gjykatës Kushtetuese.

Korniza ligjore lidhur me përmbarimin e vendimeve të Gjykatës Kushtetuese plotësohet dhe qartësohet më tej me Rregulloren e Punës së Gjykatës Kushtetuese të Kosovës . Këto rregulla përfshijnë dy dispozita që kanë të bëjnë ekskluzivisht me procedurën që duhet ndjekur në rastet kur vendimet e Gjykatës Kushtetuese nuk përmbarohen. Rregulli i drejtpërdrejtë relevant në këtë drejtim është Rregulli 66, i titulluar "Përmbarimi i vendimeve" i cili parasheh:

*"(1) Vendimet e Gjykatës Kushtetuese janë të detyrueshme për gjyqësorin dhe të gjithë personat dhe institucionet e Republikës së Kosovës*.*

[72] Vendimi i Gjykatës Kushtetuese nr. 01/2018, miratuar më 31 maj 2018, nr. ref: KK 67/18.

*(2) Të gjitha organet kushtetuese, si dhe të gjitha gjykatat dhe organet janë të obliguara t'i respektojnë, të jenë në përputhje dhe përmbarojnë vendimet e Gjykatës në kuadër të kompetencave të tyre të përcaktuara me Kushtetutë dhe ligj.*
*(3) Të gjithë personat fizikë dhe juridikë obligohen t'i respektojnë dhe t'i zbatojnë vendimet e Gjykatës.*
*(4) Gjykata në vendimin e saj mund të caktojë mënyrën dhe afatin për përmbarimin e vendimit të Gjykatës.*
*(5) Organi i obliguar për përmbarimin e vendimit të Gjykatës dorëzon informacion, nëse dhe siç kërkohet me vendim, për masat e marra për përmbarimin e vendimit të Gjykatës.*
*(6) Në rast të mospërmbarimit të vendimit, ose vonesës së përmbarimit ose informimit të Gjykatës për masat e marra, Gjykata mund të nxjerrë aktvendim me të cilin konstaton se vendimi i saj nuk është përmbaruar. Ky aktvendim botohet në Gazetën Zyrtare.*
*(7) Për të gjitha vendimet e gjykatës që nuk janë përmbaruar, njoftohet prokurori i shtetit.*
*(8) Sekretariati, nën mbikëqyrjen e gjyqtarit, i cili, në përputhje me rregullin 58, e ka hartuar vendimin, ndjek zbatimin e vendimit dhe, nëse është e nevojshme, i raporton Gjykatës me rekomandim për procedura të mëtejshme ligjore që duhet të ndërmerren."*

Paragrafi i parë i kësaj dispozite përsërit fjalë për fjalë tekstin e paragrafit të parë të Nenit 116 të Kushtetutës. Paragrafët e tjerë të rregullës 66 detajojnë më tej detyrimin për të përmbaruar vendimet e Gjykatës Kushtetuese. Paragrafët 2 dhe 3, të cituar më sipër, përcaktojnë subjektet e këtij detyrimi. Këto dispozita tregojnë se obligimi për përmbarimin e vendimeve të Gjykatës Kushtetuese mund t'u drejtohet të gjitha gjykatave dhe institucioneve publike në vend, si dhe të gjithë personave fizikë dhe juridikë që veprojnë në sistemin juridik të vendit.

Me interes të veçantë është paragrafi 4 i Rregullit 66. Ky paragraf i njeh Gjykatës Kushtetuese kompetencën për të marrë jo vetëm vendime deklarative, por për të përcaktuar natyrën e detyrimit dhe mënyrën se si të përmbarohet vendimi i saj. Gjithashtu, i njëjti paragraf njeh kompetencën e Gjykatës Kushtetuese për të përcaktuar një afat brenda të cilit përmbarohet vendimi. Edhe pse nuk parashikohet në mënyrë specifike, ne kuptojmë se në përcaktimin e mënyrës së përmbarimit dhe afateve, mund të theksohet se Gjykata Kushtetuese në vendimet e saj identifikon drejtpërdrejt edhe organin përgjegjës, publik apo privat, i cili duhet të marrë masa për përmbarimin e vendimit. Kjo rezulton nga disa vendime të Gjykatës Kushtetuese . Sipas mendimit tonë, kjo dispozitë jep qartësi për masat që duhet të marrin organet përgjegjëse për përmbarimin e vendimit të Gjykatës Kushtetuese dhe afatet kohore për zbatimin e këtyre masave.

[73] Shih për shembull paragrafin VII të pjesës së dispozitivit të vendimit të Gjykatës Kushtetuese KI190/16 datë 5.12.2017, ku Gjykata vendos "TË URDHËROJË Agjencinë Kosovare të Pronës (AKP), që në përputhje me rregullin 66 të Rregullores së Punës të Gjykatës, ta njoftojë atë sa më shpejt që të jetë e mundur, por jo më vonë se 6 (gjashtë) muaj, Gjykata Kushtetuese në lidhje me masat e marra për zbatimin e aktgjykimit të kësaj gjykate;"

Paragrafi 5 i Rregullit 66 parasheh detyrimin e organit të cilit i drejtohet vendimi i Gjykatës Kushtetuese për t'i dhënë informacion të mëvonshëm, për natyrën e detyrimit, mënyrën e përmbarimit të vendimit dhe brenda afatit të vendosur me vendim. Kjo dispozitë krijon një dialog institucional ndërmjet Gjykatës Kushtetuese dhe organeve të detyruara për të përmbaruar vendimin e të parës dhe për mendimin tonë ndihmon për përmbarimin efektiv të vendimeve. Gjykata Kushtetuese e ka shfrytëzuar këtë dispozitë si përkujtim për organet e obliguara për përmbarimin e vendimit, se nuk janë ndërmarrë hapa në këtë drejtim apo po ndërmerren me vonesë.

Nëse nuk i jepet asnjë informacion Gjykatës Kushtetuese në bazë të paragrafit 5 të Rregullit 66, dhe kur Gjykata nuk ka progres në kohë në përmbarimin e vendimeve të veta, ajo mund të miratojë, në bazë të paragrafit 6 të Rregullit 66, një vendim duke deklaruar se vendimi i saj në themel nuk është përmbaruar.

Sistemi përforcohet më tej nga dispozita e Rregullit 66 § 7 të cituar më sipër. Praktika e analizuar nga konsulentët tregon se zakonisht në momentin e miratimit të aktvendimeve të parapara në Rregullin 66 § 6, të analizuar më lart, Gjykata Kushtetuese njofton edhe Prokurorin e Shtetit. Ky njoftim duhet të lexohet së bashku me Nenin 394 të Kodit Penal (ish-neni 402 në versionin 2012 të Kodit Penal) i cili parashikon se mospërmbarimi i vendimeve gjyqësore përbën vepër penale . Kjo do të thotë se në rast të mospërmbarimit të vendimit të Gjykatës Kushtetuese mund të niset një hetim penal. Nga të dhënat e mbledhura gjatë intervistave, mund të raportohet se në shumicën e rasteve kur vendimet e Gjykatës Kushtetuese nuk janë përmbaruar, vërtetë ka nisur hetimi penal nga prokuroria. Megjithatë nuk ka të dhëna për fazën e këtyre procedurave penale pasi në shumicën e rasteve vendimet janë përmbaruar përfundimisht. Megjithatë, mbetet pyetja se çfarë nëse nuk konstatohet përgjegjësi penale në rastin konkret. Nuk duket të ketë asnjë instrument jo-penal, të natyrës ndëshkuese apo tjetër, që mund të ndihmojë në përmbarimin e vendimeve të gjykatave.

Një dispozitë tjetër e Rregullores së Gjykatës Kushtetuese sugjeron që institucionet janë të obliguara të respektojnë procedurat e asaj gjykate, me qëllim që të lehtësojnë më vonë përmbarimin e aktgjykimit që do të merret. Rregulli 71, i titulluar "Kërkesa në pajtim me nenit 113.3 (4) të Kushtetutës dhe me nenet 36 dhe 37 të Ligjit", parashikon në paragrafin 2 të tij përkatës, se:

> *"Kërkesa e parashtruar sipas këtij rregulli do të ketë një efekt pezullues."*

Kjo dispozitë i tregon organit përgjegjës se duhet të pushojë procedurën dhe të presë vendimin e Gjykatës Kushtetuese, me qëllim të qartë që më pas të miratohet një zgjidhje legjislative apo rregullatore që respekton vendimin e kësaj të fundit.

### *ii. korniza ligjore relevante për përmbarimin e vendimeve të gjykatave të rregullta në vend*

Përderisa efekti obligues i vendimeve të Gjykatës Kushtetuese shprehet qartë në nenin 116 të Kushtetutës, nuk kemi gjetur ndonjë dispozitë të ngjashme kushtetuese që parashikon efektin detyrues të vendimeve të gjykatave të rregullta në vend. Vlen të përmendet se Ligji nr. 06/L-054 "Për Gjyqësorin", përmban një dispozitë të ngjashme për këtë. Në atë dispozitë thuhet:

*"Neni 6 - Vendimet e Gjykatës*
*1. Vendimet e gjykatës hartohen në formë të shkruar, në përputhje me ligjin.*
*2. Vendimet e gjykatës janë të detyrueshme për të gjithë personat fizik dhe juridik.*
*3. Gjykatat publikojnë të gjitha aktgjykimet në faqen e tyre zyrtare të internetit, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh nga data e nxjerrjes së aktgjykimit në pajtim me legjislacionin në fuqi.*

*Këshilli nxjerr akte nënligjore për zbatimin e këtij neni."*

Praktika tregon se vështirësia në përmbarimin e vendimeve të gjykatës së rregullt reflektohet më vonë me përmbarimin e vendimeve të Gjykatës Kushtetuese. Në vijim të intervistave me gjyqtarë dhe avokatë, vlerësojmë se nuk është niveli i juridiksionit që qëndron pas vështirësive në përmbarimin e një vendimi gjyqësor, por është natyra e rastit që e bën të vështirë përmbarimin.

[74] Shih për një shembull të fundit letrën e Kryetarit të Gjykatës Kushtetuese të datës [17] prill [2014]. Ref. Nr.: KK [65/14], znj. Kada Bunjaku Përçuku, Kryetare e Gjykatës së Qarkut në Mitrovicë, duke i rikujtuar më vonë se Gjykata e Qarkut në Mitrovicë nuk e ka njoftuar Gjykatën Kushtetuese për masat e tyre përmbaruese për vendimin e kësaj të fundit në rastin KI[113/12].
[75] Ky nen parasheh: Neni [394] "Mospërmbarimi i vendimeve gjyqësore"
"[1.] Personi zyrtar apo personi përgjegjës i cili refuzon të përmbarojë urdhrin, vendimin apo aktgjykimin e plotfuqishëm të ndonjë gjykate të Republikës së Kosovës apo i cili nuk e përmbaron vendimin brenda afatit ligjor apo afatit të caktuar me vendim, dënohet me gjobë ose me burgim deri në dy [(2)] vjet.
[2.] Nëse me veprën penale nga paragrafi [1.] i këtij neni është shkaktuar shkelje e rëndë e të drejtave njerëzore apo dëm substancial material, kryesi dënohet me burgim prej gjashtë [(6)] muaj deri në pesë [(5)] vjet.
[3.] Nëse kryesi i veprës penale nga paragrafi [1.] i këtij neni e përmbaron vendimin e plotfuqishëm të gjykatës, ndjekja nuk do të ndërmerret."

[76] https://gjk-ks.org/vendimet/?prej=&deri=&lloji_i_aktit=aktvendim_mosmbarim&numri_i_rastit=08%2F09#nav-id

[77] https://gjk-ks.org/vendimet/?prej=&deri=&lloji_i_aktit=aktvendim_mosmbarim&numri_i_rastit=56#nav-id

# E. Shqyrtimi i praktikës gjyqësore përkatëse të Gjykatës Kushtetuese dhe gjykatave të rregullta

Procedura e parashikuar nga Rregulli 66, § 6 i rregullores së Gjykatës Kushtetuese, i analizuar më sipër, ngjan me atë të parashikuar në Nenin 46 § 4 të KEDNj-së. Gjykata Kushtetuese e Kosovës* deri më tani e ka përdorur këtë procedurë në këto raste:

*i.*
*Parashtruesi KI08/09: Sindikata e Pavarur e Punëtorëve të Fabrikës së Çelikut IMK në Ferizaj, Aktgjykimi i datës 17 dhjetor 2010*

*ii.*
*KI59/09 Parashtruesi Fadil Hoxha dhe 59 të tjerë kundër Kuvendit Komunal të Prizrenit, Aktgjykimi i 22 shtatorit 2010*

*iii.*
*Parashtruesi KO01/09: Qemajl Kurtishi*

*iv.*
*Parashtruesi KI 112/12: Adem Meta, Aktgjykimi i datës 5 korrik 2013*

*v.*
*Parashtruesi KI187/13: Nadežda Jovanović, Aktgjykimi i 1 prillit 2014*

*vi.*
*Parashtruesi KI132/15: Manastiri i Deçanit, Aktgjykimi i datës 19 maj 2016*

*vii.*
*Parashtruesi KI90/16: Branislav Jokić*

Sipas informacioneve të marra nga gjyqtarët dhe avokatët e intervistuar të Gjykatës Kushtetuese, rezulton se, pas nisjes së procedurës së parashikuar në Rregullin 66 § 6, vetëm tri vendime të Gjykatës Kushtetuese mbeten të papërmbaruara deri më sot. . Kjo tregon se procedura ka përfitimet e saj dhe shërben si një mjet efektiv për përmbarimin e vendimeve të Gjykatës Kushtetuese. Megjithatë, mund të vërehet se natyra e aktvendimeve të Gjykatës Kushtetuese që deklarojnë se vendimet e saj nuk janë përmbaruar, mbetet deklarative. Kjo do të thotë se aktvendimet për mospërmbarim nuk mund të detyrojnë organet e ngarkuara me përmbarimin e vendimit që të procedojnë me marrjen e masave përmbarimore siç kërkon Gjykata Kushtetuese.

Pas intervistave të zhvilluara me gjyqtarët dhe avokatët, si dhe analizën e praktikës gjyqësore përkatëse të Gjykatës Kushtetuese, konsulentët mund të konstatojnë se gjatë viteve 2014, 2015, 2019 dhe 2021 Prokurori i Shtetit është njoftuar për mospërmbarimin e aktgjykimeve të Gjykatës Kushtetuese në të gjitha rastet e përmendura më sipër në paragrafin 28 të këtij raporti . Nga analiza e pjesës së dispozitivit të këtyre vendimeve që deklarojnë mospërmbarimin e vendimeve në themel, në bazë të Rregullit 66 § 6, duket se njoftimi i Prokurorit të Shtetit, në bazë të Rregullit 66 § 7, zbatohet automatikisht në çdo rast që mospërmbarimi shpallet nga Gjykata Kushtetuese. Kjo tregon se, së pari, paragrafët 6 dhe 7 të Rregullës 66 janë të lidhura thelbësisht. Së dyti, kjo praktikë tregon se Gjykata Kushtetuese e merr seriozisht problemin e mospërmbarimit të vendimeve të saj.

[78] https://gjk-ks.org/vendimet/?prej=&deri=&lloji_i_aktit=aktvendim_mosmbarim&numri_i_rastit=01%2F09#nav-id
[79] https://gjk-ks.org/vendimet/?prej=&deri=&lloji_i_aktit=aktvendim_mosmbarim&numri_i_rastit=112#nav-id
[80] https://gjk-ks.org/vendimet/?prej=&deri=&lloji_i_aktit=aktvendim_mosmbarim&numri_i_rastit=187#nav-id
[81] https://gjk-ks.org/vendimet/?prej=&deri=&lloji_i_aktit=aktvendim_mosmbarim&numri_i_rastit=KI+132%2F15#nav-id
[82] See at https://gjk-Ks.org/vendimet/?prej=&deri=&lloji_i_aktit=aktvendim_mosmbarim&numri_i_rastit=KI90%2F16#nav-id

These decisions are:
a- Parashtruesi KI[08/09]: Sindikata e Pavarur e Punëtorëve të Fabrikës së Çelikut IMK në Ferizaj – Vlerësim i kushtetutshmërisë së Vendimit të Gjykatës Komunale në Ferizaj C nr. 349/2001.
• Aktgjykimi u mor më [17] dhjetor [2010]. Gjykata ishte njoftuar nga pala përkatëse se aktgjykimi nuk ishte duke u përmbaruar. Pas një sërë korrespondencash me palët përkatëse janë ndërmarrë hapat e mëposhtëm:
'Gjykata ka marrë aktvendim për mospërmbarim në rastin KI[08/09] më [18] tetor [2012];
'Gjykata e ka njoftuar Prokurorin e Shtetit për mospërmbarim të aktgjykimit në rastin KI[08/09], më [28] maj [2019]

b-Parashtruesi KI[132/15]: Manastiri i Deçanit · Vlerësimi i kushtetutshmërisë së dy vendimeve· AC-I-13-0008 dhe AC-I-13-0009, të Kolegjit të Ankesave të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës* për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit*
• Aktgjykimi u mor më [19] maj [2016]. Gjykata ishte njoftuar nga pala përkatëse se aktgjykimi nuk ishte duke u përmbaruar. Pas një sërë korrespondencash me palët përkatëse janë ndërmarrë hapat e mëposhtëm:
'Gjykata ka marrë aktvendim për mospërmbarim në rastin KI[132/15] më [22] shtator [2021];
'Gjykata e ka njoftuar Prokurorin e Shtetit për mospërmbarim të aktgjykimit në rastin KI[132/15], më [24] shtator [2021];

c-Parashtruesi KI[90/16]: Branislav Jokić 'anëtar i komunitetit joshumicë[a]' · Vlerësim i kushtetutshmërisë së mospërmbarimit të Vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës*· KKPK∂R[230/2014], datë [13] mars [2014]
•Aktgjykimi u mor më [5] dhjetor [2017]. Gjykata ishte njoftuar nga pala përkatëse se aktgjykimi nuk ishte duke u përmbaruar. Pas një sërë korrespondencash me palët përkatëse janë ndërmarrë hapat e mëposhtëm:
'Gjykata ka marrë aktvendim për mospërmbarim në rastin KI[90/16] më [18] korrik [2022];
'Gjykata e ka njoftuar Prokurorin e Shtetit për mospërmbarim të aktgjykimit në rastin KI[90/16], më [2] gusht [2022];
Në asnjë prej këtyre rasteve Gjykata Kushtetuese nuk është njoftuar për ndonjë hap të ndërmarrë në drejtim të përmbarimit të vendimeve përkatëse

## F. Mbledhja e të dhënave nga Gjykata Kushtetuese dhe palët e tjera të interesit relevante për përmbarimin e vendimeve të Gjykatës Kushtetuese *(takimet e grupeve punuese online)*

Paragrafi 8 i Rregullit 66, sqaron se regjistri i Gjykatës Kushtetuese, i udhëhequr nga gjyqtari raportues në rastin konkret, pason përmbarimin e aktgjykimit të Gjykatës Kushtetuese. Gjatë intervistave, konsulentët u informuan se në Gjykatën Kushtetuese është krijuar vërtet një grup punues, i udhëhequr nga Kryetarja, aktualisht znj. Gresa Caka-Limani, që ndjek procesin e përmbarimit të aktgjykimeve të Gjykatës Kushtetuese. Ky grup punues takohet zakonisht dy herë në vit. Ndjekja e procesit të përmbarimit regjistrohet rregullisht në një dokument Excel, i cili shërben si bazë për diskutimin e grupit punues. Në takime, gjyqtarët dhe avokatët e Gjykatës Kushtetuese vlerësojnë ecurinë ose mungesën e saj, si dhe hapat që duhet të ndërmerren. Formati, periodiciteti dhe funksionimi i këtij grupi punues tregon vëmendjen që Gjykata Kushtetuese i kushton procesit të përmbarimit të vendimeve të veta.

## G. Dialogu ndërmjet Gjykatës Kushtetuese dhe institucioneve të tjera

Zbatimi i aktgjykimeve të Gjykatës Kushtetuese të Kosovës duhet të jetë analiza e përgjegjësisë së përbashkët gjyqësore ndërmjet kësaj gjykate dhe gjykatave të tjera kombëtare, por edhe si përgjegjësi e përbashkët me pjesën përmbaruese dhe legjislative të shtetit. Prandaj, është e rëndësishme të analizohet roli i Gjykatës Kushtetuese në zbatimin e aktgjykimeve të veta dhe roli i gjykatave kombëtare në zbatimin e aktgjykimeve. Një nga çështjet thelbësore në marrëdhëniet ndërmjet Gjykatës dhe autoriteteve kombëtare është parimi i ligjshmërisë dhe synimi për një sistem ligjor të qëndrueshëm. Kjo vendos detyrime për të gjitha pjesët e kompetencave të shtetit në përmbarimin e aktgjykimeve të Gjykatës Kushtetuese. Gjykatat më të larta kombëtare si gjykata Supreme dhe ato të Apelit luajnë një rol vendimtar në zbatimin e aktgjykimeve të Gjykatës Kushtetuese për shkak të pozicionit të tyre hierarkik në gjyqësorin vendor. Nga kjo rrjedh se gjykatat në Kosovë* duhet të merren me njëra-tjetrën me respekt të lartë reciprok.

Gjykata Kushtetuese duhet të jetë shumë aktive në zhvillimin e dialogut gjyqësor me gjykatat e tjera kombëtare dhe duhet të krijojë një bazë të fortë për bashkimin e institucioneve të tjera përgjegjëse për përmbarimin e aktgjykimeve. Kjo do të jetë mundësia për të pasur një shkëmbim të drejtpërdrejtë mbi çështjet procedurale dhe thelbësore me gjykatat e nivelit të lartë dhe partnerët e tjerë të Gjykatës Kushtetuese të Kosovës*. Ka shumë sfida të përbashkëta për të gjitha gjykatat kombëtare, si për shembull, praktika gjyqësore e qëndrueshme për mbrojtjen e të drejtave të njeriut, problemet që lidhen me njohuritë mbi gjykimin e frikës, migrimin dhe terrorizmin, digjitalizimin etj. Dialogu ndërmjet gjykatave është sinjal për mbrojtje më të mirë të sundimit të ligjit.

[84] Shih edhe paragrafin 2 të këtij Raporti.

[85] Opinioni nr. 4 i Këshillit Konsultativ të Gjyqtarëve Evropianë (KKGJE) në vëmendje të Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës për trajnimin e duhur fillestar dhe gjatë shërbimit për gjyqtarët në nivel kombëtar dhe evropian.

# H. Trajnimi dhe edukimi

Trajnimi dhe edukimi i gjyqtarëve dhe avokatëve janë elementë të rëndësishëm për zbatimin dhe përmbarimin e drejtë të aktgjykimeve dhe për të siguruar që politikat publike të mos bllokojnë mbrojtjen e të drejtave themelore. Trajnimi profesional është nxitësi më i rëndësishëm për të zhvilluar njohuri dhe shkathtësi për të mbrojtur përmbarimin e duhur të aktgjykimeve. Gjyqtarët kanë për detyrë të kryejnë punën gjyqësore në mënyrë profesionale dhe kjo do të ndihmojë në ngritjen e aftësive profesionale përmes trajnimeve . Në përputhje me objektivat e saj strategjike aktuale, akademia kombëtare ose organe të tjera të specializuara për edukimin dhe trajnimin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në nivel kombëtar duhet të fokusohen jo vetëm në trajnimin dhe edukimin për të drejtat themelore dhe praktikën gjyqësore të GjED-Nj-së, por në kurrikulat e tyre duhet të përcaktojë edhe edukimin dhe trajnimin për zbatimin dhe përmbarimin e aktgjykimeve të Gjykatës Kushtetuese.

Në përputhje me detyrën e përbashkët për edukimin dhe trajnimin e profesionistëve në gjyqësor, synimet strategjike në të ardhmen duhet të jenë ngritja e nivelit të njohurive për përmbarimin dhe zbatimin e aktgjykimeve; të punohet për bashkëpunim efektiv të brendshëm ndërmjet institucioneve përgjegjëse për zbatimin e aktgjykimeve, të punohet për bashkëpunim të jashtëm dhe formën e vazhdueshme të dialogut ndërmjet Gjykatës Kushtetuese dhe gjykatave të tjera kombëtare; të përforcohet, sa më shumë që të jetë e mundur, përparësia e rolit të institucioneve kombëtare të specializuara për trajnim dhe edukim në të gjitha fushat e trajnimit gjyqësor në nivel kombëtar.

[86] Shih paragrafin 44, sipër. Shih për shembull vendimin e Gjykatës Kushtetuese të Kosovës të datës 06.04.2023 në lëndën nr. KI14/22.

## I. Public awareness and presentation of new judgment

Është jashtëzakonisht e rëndësishme të rritet ndërgjegjësimi për aktgjykimet e reja, veçanërisht për standardet dhe parimet e reja, apo aktgjykimet që lidhen me problemet sistematike në vend. Prandaj, në momentin kur aktgjykimi shpallet dhe publikohet në databazën e Gjykatës Kushtetuese, ai duhet të publikohet së bashku me një përmbledhje ligjore të aktgjykimit. Përmbledhjet ligjore janë të rëndësishme për gjyqtarët kombëtarë, profesionistë të tjerë, për qëllime kërkimore, për parashtruesit ose çdo person tjetër të interesuar në praktikën gjyqësore të Gjykatës.

Detyra e ndërgjegjësimit të publikut për standardet e reja të vendosura nga praktika gjyqësore mund të jetë pjesë e punës së shërbimit të shtypit të Gjykatës që mund të jetë nga gjyqtarët e Gjykatës, Regjistri dhe avokatët që punojnë në rast konkret. Qëllimi i shërbimit të shtypit është të ofrojë informacion të disponueshëm publikisht për çështjet dhe të drejtojë publikun në përdorimin e databazës së Gjykatave Kushtetuese për rastet e mëparshme. Zyrtarët e shtypit të Gjykatës duhet të jenë të disponueshëm për të informuar gazetarët me email ose me telefon ose duke përdorur njoftime për shtyp.

Gjykata duhet të përpiqet të pranojë sfidat e reja në kohën e internetit dhe mjeteve të tjera të reja për informacion. Prandaj, duke ndjekur shembullin e GjEDNj-së, Gjykata Kushtetuese mund t'u ofrojë atyre që janë të interesuar për punën e Gjykatës Kushtetuese, ta ndjekin Gjykatën në Twitter, ose duke u abonuar në listën e postimeve për njoftim për shtyp.

## III. Përfundime dhe rekomandime

i. Rekomandime për marrjen e komenteve mbi përmbarimin nga parashtruesit dhe të anketuarit (palët)

Gjatë takimeve të mbajtura në Prishtinë, Strasburg dhe online, Konsulentëve iu tha se për qëllime të përcjelljes së përmbarimit të vendimit të Gjykatës Kushtetuese, përgjegjës është gjyqtari raportues i rastit konkret. Gjyqtari raportues, i ndihmuar nga regjistri i Gjykatës, ndjek, identifikon, klasifikon dhe vlerëson informacionin që ka të bëjë me përmbarimin e vendimit të caktuar. Ky informacion shërben më vonë, nëse është e nevojshme, si bazë për diskutimin në grupin punues të përmendur në paragrafin e mëparshëm të këtij raporti dhe kur gjykohet se procesi i përmbarimeve ka ngecur me një vonesë të pajustifikuar ose në çdo rast në kundërshtim me indikacionet e vendimit të Gjykatës, të nisë procedurën e parashikuar në Rregullin 66, të analizuar më sipër. Kjo do të thotë se procedura e Rregullës 66 mund të fillohet ex officio nga vetë Gjykata.

Megjithatë, nga intervistat rezulton se edhe palët, parashtruesit dhe të padituri në rastin para Gjykatës Kushtetuese mund ta informojnë këtë të fundit për masat e përmbarimit ose mungesën e tyre. Kjo duket një zgjidhje e arsyeshme për të mos e stërngarkuar Gjykatën Kushtetuese me një proces që nuk është fokusi kryesor i misionit të saj dhe për t'i mundësuar që ajo të drejtojë burimet e saj të kufizuara në funksionin gjyqësor.

### ii. Rekomandim për metodologjitë gjyqësore që do të përdorë Gjykata Kushtetuese

Është e vërtetë se Gjykata Kushtetuese tregon, në përputhje me Rregullin 66 § 5, subjektin përgjegjës për përmbarimin e aktgjykimit dhe afatin për të informuar Gjykatën Kushtetuese për masat e marra në këtë drejtim. Kjo është masë e cila është miratuar edhe nga disa gjykata të tjera kushtetuese në Evropë . Konsulentët vlerësojnë se është e rëndësishme që Gjykata Kushtetuese të vazhdojë të tregojë qartë dhe në mënyrë konsistente subjektet që janë përgjegjëse për përmbarimin e aktgjykimit të saj dhe të tregojë gjithmonë një afat të qartë për përmbarimin e aktgjykimit.

Masat për përmbarimin e aktgjykimit të Gjykatës Kushtetuese duhet të jenë në përputhje me konkluzionet e aktgjykimit. Për zbatimin efektiv dhe më të mirë, aktgjykimet duhet të jenë të qarta, të përpunuara mirë dhe të arsyetuara. Në këtë drejtim, në disa raste mund të jetë e nevojshme të shtjellohen më në detaje, në pjesën e dispozitivit të aktgjykimit, masat që duhet të ndërmerren nga autoritetet, duke iu referuar përfundimisht paragrafëve që përmbajnë ratio të aktgjykimit të Gjykatës, ose duke specifikuar në detaje masën që do të merret.

Çështja e sanksioneve monetare dhe e dëmeve monetare mund të diskutohet edhe me të gjitha palët e interesit, duke përfshirë edhe interesat përkatëse në rast të përmbarimit të vonuar të aktgjykimit të Gjykatës. Masa të tilla mund të diskutohen/parashikohen veçanërisht në rastet kur mospërmbarimi nuk rrjedh nga vështirësi strukturore, institucionale apo procedurale, por është rezultat i mungesës së vullnetit të pastër për të përmbaruar aktgjykimin.

Gjykatat Kushtetuese duhet të iniciojnë vendosjen e procedurës pilot të aktgjykimit për kërkesat që kanë të bëjnë me ekzistencën e një problemi strukturor apo sistemik. Procedura pilot e aktgjykimit ka për qëllim zgjidhjen e problemeve sistemike por edhe parandalimin e kërkesave të mëtejshme masive. Një procedurë pilot aktgjykimi do të kërkojë bashkëpunim të mirë me ligjvënësit dhe qeverinë. Megjithatë, Gjykata Kushtetuese do të tregojë masat që nga njëra anë janë mjaftueshëm të qarta për të udhëhequr ligjvënësit dhe qeverinë në marrjen e masave të reja për zgjidhjen e këtyre çështjeve, nga ana tjetër duhet të jetë mjaft e matur për t'u lënë atyre hapësirën e nevojshme që të gjejnë mënyrave më të mira për të ndërmarrë masat e nevojshme.

### iii. Rekomandime për format e shqyrtimit vjetor ose periodik të përmbarimit të aktgjykimeve

Nga paragrafët e mësipërm të këtij raporti duket qartë se Gjykata Kushtetuese është mjaft e përkushtuar dhe e fokusuar në përmbarimin e vendimeve të saj. Mbledhjet dyvjeçare të grupit punues të Gjykatës Kushtetuese për përmbarimin e vendimeve, mund të konsiderohen si një mjet i përshtatshëm, duke funksionuar në intervale të arsyeshme, për të vlerësuar çështjen e përmbarimit të vendimeve të Gjykatës Kushtetuese.

Megjithatë, nuk ka informacione se takime të tilla zhvillohen në organe të tjera gjyqësore apo në kuadër të Këshillit Gjyqësor, për të trajtuar një problem që duket të jetë më problematik në nivel të gjykatave të rregullta.

Gjykata Kushtetuese dhe ajo Supreme duhet të udhëhiqen nga ideja për një dialog mes tyre dhe gjykatave të tjera, me qëllim zbatimin më të mirë të legjislacionit dhe përmbarimin efektiv të aktgjykimeve. Dialogu i mirë do të sjellë njohuri më të mirë të rolit të gjyqtarëve dhe të rëndësisë së përmbarimit të aktgjykimeve në kohën e epokës digjitale.

Kuvendi duhet të respektojë aktgjykimet e Gjykatës Kushtetuese. Bashkëpunimi me gjykatat kushtetuese duhet të bëhet në të njëjtën mënyrë nga ana e organeve administrative, të çdo institucioni tjetër.

Do të ishte e përshtatshme të krijohej një mekanizëm monitorues i përmbarimit të vendimeve gjyqësore të formës së prerë jashtë organeve gjyqësore, si Avokati i Popullit, Ministria e Drejtësisë, Parlamenti, etj.

Në vijim të asaj që u tha më lart, do të ishte shumë e dobishme, për qëllime të shqyrtimit periodik dhe për qëllime ndërgjegjësimi, që Avokati i Popullit të përfshijë një kapitull të veçantë për përmbarimin e aktgjykimeve të Gjykatës Kushtetuese në raportin vjetor të veprimtarisë së tyre përpara Kuvendit.

Për sa i përket përmbarimit të aktgjykimeve të Gjykatës Kushtetuese, duhet të ketë mbledhje të përbashkëta vjetore të gjykatave të larta, ligjvënësit, qeverisë dhe organeve administrative përgjegjëse që mblidhen dhe diskutojnë aktgjykimet që janë në proces përmbarimi. Mund të parashikohet edhe një takim i veçantë publik, kushtuar përmbarimit të aktgjykimeve të Gjykatës Kushtetuese, i organizuar nga Komisioni i Kuvendit për çështje Juridike, me të gjitha institucionet e interesuara.

87 Shih paragrafët 29-32, sipër.
88 See paragraphs 29-32, above.
89 Shih për shembull Rregulloren e Punës së Gjykatës Kushtetuese të Bosnjës dhe Hercegovinës e cila parasheh:
Neni 74 (Kompensimi për dëmin jopasuror)
"(1) Gjykata Kushtetuese me vendimin për pranimin e ankesës mund të caktojë kompensim për dëmin jopasuror.
(2) Nëse Gjykata Kushtetuese konsideron se kompensimi i dëmit pasuror është i nevojshëm, do ta caktojë atë në baza të drejta duke marrë parasysh standardet e përcaktuara në praktikën gjyqësore të Gjykatës Kushtetuese."

### iv. Rekomandime për alokimin e burimeve njerëzore

Gjykata Kushtetuese nuk ka një strukturë të dedikuar institucionale të fokusuar në përmbarimin e vendimeve. Siç u përmend më lart, ekziston vetëm Grupi Punues i udhëhequr nga Kryetari i Gjykatës, i cili mblidhet dy herë në vit për të ndjekur atë proces. Duke pasur parasysh numrin e kufizuar të stafit në Gjykatën Kushtetuese, numrin e kufizuar të vendimeve të Gjykatës Kushtetuese që mbeten të papërmbaruara deri më sot dhe për faktin se përmbarimi i vendimeve gjyqësore nuk është, në vetvete, një funksion gjyqësor, konsulentët nuk do të këshillonin krijimin e një strukture të veçantë për këtë qëllim.

### v. Rekomandim për ngritjen e vetëdijesimit për përmbarimin e vendimeve të Gjykatës Kushtetuese

Është e rëndësishme që përmbarimi i aktgjykimeve të Gjykatës Kushtetuese të Kosovës* të perceptohet si përgjegjësi kolektive e qeverisë, parlamentit, gjyqtarëve kombëtarë dhe organeve të tjera administrative. Koncepti i shtetit përgjegjës është ndërtuar mbi mirëkuptimin reciprok se të drejtat e njeriut dhe zbatimi i tyre i përkasin shteteve.

Rëndësia e përmbarimit të aktgjykimeve është e lidhur ngushtë me rrezikun e shkeljes së përsëritur të të drejtave individuale. Detyrimi për përmbarimin e aktgjykimeve është i zbatueshëm për të gjitha pushtetet shtetërore në mënyrë të barabartë. Prandaj, është e rëndësishme të kihet parasysh efekti detyrues i aktgjykimeve të Gjykatës Kushtetuese të Kosovës dhe për këtë qëllim duhet të ketë një aktivitet monitorues sistematik të përmbarimit të aktgjykimeve.

Është e rëndësishme të mbahet një dialog i hapur dhe i besueshëm me median dhe të informohet publiku për aktgjykimet, vendimet dhe metodat e reja të punës. Gjykata Kushtetuese mund të ndjekë shembullin e GjEDNj-së në përdorimin e mediave sociale për të dërguar mesazhe të rëndësishme të disa aktgjykimeve të reja. Në këtë drejtim, mund të jetë e dobishme të përdorni për shembull Twitter, Facebook ose ndonjë media tjetër sociale.

Shërbimi i shtypit mund të ndihmojë Gjykatën Kushtetuese në shpërndarjen e publikimeve, deklaratave, shënimeve informative të përgatitura nga Regjistri i Gjykatës Kushtetuese. Kjo qasje do të japë rezultate pozitive për publikun dhe do ta afrojë punën e gjykatës me publikun. Deklaratat për shtyp dhe përmbledhjet e shkurtra dhe informative ligjore do të ndihmojnë në informimin e publikut por edhe të institucioneve juridike, komunitetit akademik dhe shoqërisë civile për aktgjykimet përfundimtare dhe detyruese të Gjykatës Kushtetuese ose të GjEDNj-sënity, and civil society about the final and binding judgements of the Constitutional court or of the ECtHR.

Praktika e Gjykatës Kushtetuese sllovene, e përshkruar më sipër, mund të aplikohet. Gjykata Kushtetuese e Kosovës mund ta konsiderojë të dobishme që t'i kushtojë një kapitull të veçantë dhe duke filluar me të, raportin e saj vjetor të aktiviteteve.

Është e rëndësishme të krijohet një rrjet me gjykatat dhe të zhvillohen konferenca, takime në tryeza të rrumbullakëta me gjyqtarë dhe prokurorë nga gjykatat e shkallës së parë, gjykatat e apelit, institucionet kombëtare të të drejtave të njeriut si Institucioni i Avokatit të Popullit dhe Institucioni i të Drejtave të Njeriut dhe i Barazisë.

***Konsulentët***

***Mirjana Lazarova Trajkovska***
***Ledi Bianku***

# Shtojcë - Indeksi terminologjik dhe burimet

**Indeksi terminologjik:**

• KEDNj – Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore (ku termi 'Konventë' përdoret pa ndonjë specifikim, gjithmonë nënkuptohet si Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore)

• GjEDNj - Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut

• Komiteti i Ministrave - Komiteti i Ministrave të Këshillit të Evropës

• GjDBE – Gjykata e Drejtësisë e Bashkimit Evropian

• CEPEJ - Komisioni Evropian për Efikasitetin e Drejtësisë

• BE - Bashkimi Evropian

• TFBE – Traktati mbi Funksionimin e Bashkimit Evropian

• TBE – Traktati për Bashkimin Evropian

**Burimet:**


• Traktatet dhe aktet e Gjykatave Rajonale Evropiane
  - *Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut*
  - *TFBE – Traktati mbi Funksionimin e Bashkimit Evropian*
  - *TBE – Traktati për Bashkimin Evropian*
  - *Rregullorja e Punës e GjEDNj-së*
  - *Rregullorja e Punës e GjDBE-së*

• **Aktgjykimet e GjEDNj-së:**

*- Baybaşin k. Holandës, kërkesa nr. 13600/02, 06.07.2006.*
*- Emre v. Switzerland (No. 2), app. no. 5056/10, 11/10/2011.*
*- Greens and M.T. v. the United Kingdom, 2010*
*- Guðmundur Andri Ástráðsson v. Iceland [GC], 2020*
*- Hornsby v. Greece, app no. 18357/91, 19 March 1997.*
*- Ilgar Mammadov v. Azerbaijan, app. no. 15172/13, [GC], 29/05/2019*
*- Jeronovičs v. Latvia, app. no. 44898/10, [GC], 05/07/2016,*
*- Kavala v. Türkiye, app no. 28749/18, [GC] 11/07/2022.*
*- Moreira Ferreira v. Portugal (no. 2) [GC], 2017,*
*- Scordino v. Italy (no. 1) [GC], application no. 36813/97 29.06.2006.*
*- Suso Musa v. Malta, application no. 42337/12, 23.07.2013.*
*- Verein Gegen Tierfabriken Schweiz (VgT) v. Switzerland (No. 2), app. no. 32772/02, [GC], 30/06/2009*

• **Rezolutat e Komitetit të Ministrave:**

*-Rezoluta e Komitetit të Ministrave H46-27 Kavala k. Turqisë (Kërkesa nr. 28749/18), mbledhja e 1459-të, 7-9 mars 2023 (DH)*
*-Rezoluta e Përkohshme CM/ResDH(2023)36, Selahattin Demirtaş (Nr. 2) k. Turqisë, (miratuar nga Komiteti i Ministrave më 9 mars 2023, në mbledhjen e 1459-të të Zëvendësministrave).*

• Rregullat e Komitetit të Ministrave

• Gazeta Zyrtare e Bashkimit Evropian 29.9.2012

• Kushtetutat kombëtare dhe ligjet për gjykatat kushtetuese

*- Kushtetuta e Azerbajxhanit*
*- Ligji për Gjykatën e Arbitrazheve në Belgjikë*
*- Ligji për Gjykatën Kushtetuese në Bullgari,*
*- Kushtetuta e Bosnjës dhe Hercegovinës*
*- Rregullorja e Punës e Gjykatës Kushtetuese të Bosnjës dhe Hercegovinës*
*- Kushtetuta e Republikës Çeke*
*- Akti Kushtetues i Gjykatës Kushtetuese në Kroaci*
*- Kushtetuta e Kosovës**
*- Rregullorja e Punës e Gjykatës Kushtetuese të Kosovës*
*- Ligji për Gjykatën Kushtetuese të Hungarisë.*
*- Kushtetuta e Francës*
*- Kushtetuta e Italisë*
*- Ligji për Gjykatën Kushtetuese të Lituanisë.*
*- Kushtetuta e Maltës*
*- Kushtetuta e Polonisë.*
*- Ligji për Gjykatën Kushtetuese të Sllovakisë*
*- Kushtetuta e Sllovakisë*
*- Ligji për Gjykatën Kushtetuese të Sllovenisë.*
*- Ligji Organik për Gjykatën Kushtetuese të Spanjës*

• **Vendimet e Gjykatës Kushtetuese të Kosovës**

*- Parashtruesi KI08/09: Sindikata e Pavarur e Punëtorëve të Fabrikës së Çelikut IMK në Ferizaj, Aktgjykimi i datës 17 dhjetor 2010*
*- KI59/09 Parashtruesi Fadil Hoxha dhe 59 të tjerë kundër Kuvendit Komunal të Prizrenit, Aktgjykimi i 22 shtatorit 2010*
*- Parashtruesi KO01/09: Qemajl Kurtishi*
*- Parashtruesi KI 112/12: Adem Meta, Aktgjykimi i datës 5 korrik 2013*
*- Parashtruesi KI187/13: Nadežda Jovanović, Aktgjykimi i 1 prillit 2014*
*- Parashtruesi KI132/15: Manastiri i Deçanit, Aktgjykimi i datës 19 maj 2016*
*- Parashtruesi KI90/16: Branislav Jokić*

• **Raportet**

*- Komisioni Evropian për Efikasitetin e Drejtësisë (CEPEJ) "Udhëzues i praktikave të mira për zbatimin e vendimeve gjyqësore" siç u miratua në seancën e 26-të Plenare të CEPEJ-it, 10-11 dhjetor 2015*

*- Opinioni nr. 4 i Këshillit Konsultativ të Gjyqtarëve Evropianë (KKGJE) në vëmendje të Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës për trajnimin e duhur fillestar dhe gjatë shërbimit për gjyqtarët në nivel kombëtar dhe evropian.*

*- Master of the Rolls, Lord Woolf, Raport mbi sistemin civil anglez (1996)*

• **Doktrina**

*- Lord Lester of Herne Hill QC, Qasja në drejtësi, Interights-Buletin, (Shqyrtim i Qendrës Ndërkombëtare për Mbrojtjen Ligjore të të Drejtave të Njeriut - ISSN 0268-3709 1996 Vëllimi 10 Nr. 2*

www.coe.int

Këshilli i Evropës është organizata kryesore e kontinentit për të drejtat e njeriut. Në të bëjnë pjesë 46 shtete anëtare, duke përfshirë të gjitha shtetet anëtare të Bashkimit Evropian. Të gjithë shtetet anëtare të Këshillit të Evropës kanë nënshkruar Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut, dokument i cili është hartuar për të mbrojtur të drejtat e njeriut, demokracinë dhe shtetin e së drejtës. Gjykata Evropiane mbikëqyr zbatimin e Konventës nga shtetet anëtare

COUNCIL OF EUROPE

CONSEIL DE L'EUROPE